

Informacion periodik mbi riskun Q4-2017

Tabela 4: Mjaftueshmeria e kapitalit

Informacion cilësor

Grupi bankar ben perlogaritjen e kapitalit regulator sipas kerkesave te rregullores "Për kapitalin rregullator të bankës", ne fuqi nga data 30.06.2015

Informacion sasior

RREZIKU I KREDISE

Tabela me poshte detajon zërat e ekspozimeve dhe ekspozimeve te ponderuara me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuar respektivisht në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit". (Vlerat ne Leke)

040	1.	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)	88,697,327,590.14
050	1.1	Klasat e ekspozimit sipas SA duke përjashtuar pozicionet e titullimit	88,697,327,590.14
060	1.1.1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	2,080,904,323.44
070	1.1.2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	0
080	1.1.3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	8,042,172.23
090	1.1.4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	0
100	1.1.5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	0
110	1.1.6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	7,427,838,336.57

120	1.1.7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	39,075,327,975.16
130	1.1.8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	22,392,073,294.57
140	1.1.9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	2,777,591,635.95
150	1.1.10	Ekspozime (kredi) me probleme;	4,339,294,553.32
160	1.1.11	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	2,386,571,905.08
170	1.1.12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	3,088,460,512.50
180	1.1.13	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	0
190	1.1.14	Zëra të tjerë	5,121,222,881.32
200	1.2	Pozicionet e titullzimit SA	
200*	1.2*	<i>nga të cilat: rititullzime</i>	

RREZIQET E TREGUT

Tabela me poshte permbledh kërkesen për kapital për rrezikun e tregut, e llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”(Vlerat ne leke)

210	2.	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	1,919,071,973.00
220	2.1	Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes	0
230	2.1.1	Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	0
240	2.1.2	Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	0
250	2.2	Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)	1,919,071,973.00
260	2.2.1	Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	1,267,787,620.23
270	2.2.2	Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	0
280	2.2.3	Rreziku i kursit të këmbimit	651,284,352.77

290	2.2.4	Rreziku i investimeve në mallra	0
300	2.3	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në librin e tregtueshëm	

RREZIKU OPERACIONAL

Tabela e mëposhteme detajoj kërkesen për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit

310	3.	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	22,071,347,317.57
320	3.1	Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	
330	3.2	Metoda Standarde / Standarde Alternative	22,071,347,317.57
340	4.	Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorzidentëve, në valutë	2,166,029,575.06
350	4.1	Totali i zërave të pasivit "Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare" dhe "Veprime me letrat me vlerë" të jorzidentëve, në valutë, e dy viteve më parë	48,625,214,754.75
360	4.2	Totali i zërave të aktivitetit i “Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “Veprimeve me letrat me vlerë”, jorzidente në valutë në periudhën raportuese	50,800,724,973.40
370	4.3	Rritja e zërave të aktivitetit i “Veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare” dhe “Veprimeve me letrat me vlerë” të jorzidentëve, në valutë	2,175,510,218.65
380	4.4	Totali i zërave të pasivit "Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare" dhe "Veprime me letrat me vlerë" të jorzidentëve, në valutë, e dy viteve më parë	270,007.79
390	4.5	Totali i zërave të pasivit i “Veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare” dhe “Veprimeve me letrat me vlerë” të jorzidentëve, në valutë, në periudhën raportuese	9,750,651.38
400	4.6	Rritja e zërave të pasivit i “Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “Veprimeve me letrat me vlerë” të jorzidentëve, në valutë	9,480,643.59

Tabelë 6: Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm

Raiffeisen Bank Albania dhe Raiffeisen Leasing SH.A. perllorarin fonde rezerve në bazë të dy standarteve Rregullave të percaktuara nga Banka e Shqipërisë për Administrimin e Rrezikut të Kredive dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Fondet rezerve krijohen në momentin kur ekziston një evidence objektive për humbjen.

Evidencë objektive që një aktiv financiar ose grup aktivesh është i zhvlerësuar përfshin të dhënat e mbikëqyrura, në bazë të ngjarjeve të mëposhtme:

- a) Vështiresi financiare të huamarresit,
- b) Shkelje të kontratës,
- c) Falimentimi ose riorganizime të tjera financiare,
- d) Ndryshime negative në statusin e pagesave të huamarresit,
- e) Mashtrime nga ana e klientit

Provizionet sipas standarteve të Bankës së Shqipërisë, për RBAL, perllorahen në përputhje të plote me standartet e percaktuara në rregulloren "Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë nga Bankat dhe Degët e Bankave të Huaja". Nderkohë, RLAL perllorahet provizionet lokale duke u bazuar në rregulloren "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka", miratuar me vendimin nr.02, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar IAS 39 & IAS 37, Grupi Bankar, kalkulon dy tipe të provigjoneve:

- Fonde rezerve për humbje individuale të kredive
- Fonde rezerve për humbje kolektive të kredive
- Fonde rezerve për humbje kolektive të pjesës së përdoruar të kredive

Ky kalkulim bëhet në bazë mujore.

Provizjone individuale

Nëse evidencia objektive e rëndësishme e humbjes ekziston individualisht kreditë e tilla duhet të vlerësohen në mënyrë individuale dhe janë të përjashtuara nga provizionet kolektive. Provizionet individuale krijohen për kreditë që nuk performojnë.

Fondi rezervë për kreditë e pasiguruara është e barabartë me prodhimin e ekspozimit të kredisë me përqindjen e humbjes (si rezultat i metodave të brendshme statistikore). Ndersa për kreditë e siguruara fondi rezerve është diferencë e ekspozimit të kredisë me vlerën e kolateralit.

Provizjone kolektive

Humbjet që nuk mund të identifikohen në bazë individuale të kredisë ende mund të jetë i identifikueshëm në bazë portofoli. Për këtë arsye, të gjitha llogaritë pa fakte të konsiderueshme të humbjes së janë të përfshira në një grup aktivesh financiare të ngjashme për vlerësimin kolektiv. Keto humbje janë të bazuara në modelet e brendshme statistkukore të bankës, të cilat reflektojnë profilin e riskut të klientit dhe të produktit.

Ky fond është i barabartë me ekspozimin e kredise shumezuar me probabilitetin e humbjes se kredise, ne baze te dite vonsesave te kredise, e zvogeluar me mundesine e kredise per ripagim.

Raiffeisen Leasing Albania perlllogarit fondet rezerve ne

Tabelë 7: Rreziku i kredisë : Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standard

Ne tabelen me poshte mund te gjeni nje informacion përmbledhës për secilën klasë të ekspozimit sipas klasifikimit në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” që përfshin:

- i) emrat e Institucioneve të jashtëm të vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencive të kreditimit të eksporteve (ECA);
- ii) klasat e ekspozimit për të cilën është përdorur Institucioni i jashtëm i vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencia e kreditimit të eksporteve (ECA)

a)	KLASAT E EKSPOZIMIT	EMERTIMI I KLASAVE TE EKSPOZIMIT	EMRI I INSTITUCIONIT TE JASHEM TE VLERESIMIT (ECAI)
	a	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	b	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	c	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	d	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
	e	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	-
	f	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS

g	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
h	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
i	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	-
j	Ekspozime (kredi) me probleme;	-
k	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	-
l	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
m	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	
o	Zëra të tjerë	-

Tabela me poshte detajon Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së kredisë para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, si dhe vlerat e ekspozimeve të zbritshme nga kapitalit rregulator, sipas klasave të ekspozimit në bazë të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

Njesia monetare: ALL			
KLASAT E EKSPOZIMIT	EMERTIMI I KLASAVE TE EKSPOZIMIT	EKSPOZIMI PARA APLIKIMIT TE TEKNIKAVE TE ZBUTJES	EKSPOZIMI PAS APLIKIMIT TE TEKNIKAVE TE ZBUTJES
a	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qëndrore ose bankave qëndrore;	89,926,434,381.21	109,903,362,976.48
b	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	0	0
c	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare(organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	192,777,500.14	232,988,360.59
d	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	0	760,799,143.53

e	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	0	0
f	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	37,338,750,194.41	37,348,571,077.96
g	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	66,525,414,552.19	43,145,623,415.88
h	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	31,521,727,237.74	31,307,687,017.20
i	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	4,585,828,317.12	4,585,828,317.12
j	Ekspozime (kredi) me probleme;	3,495,904,162.97	3,495,779,301.60
k	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	1,591,047,936.72	1,591,047,936.72
l	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	15,442,302,562.49	15,442,302,562.49
m	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	0	0
o	Zëra të tjerë	8,742,222,480.55	8,742,222,480.55
	Ekspozime te zbritshme nga kapitali rregullator	1,805,037,786.85	1,805,037,786.85

Tabelë 8: Teknikat e zbutjes së rrezikut

Me qëllim zbutjen e rrezikut të kredise Banka Raiffeisen përdor disa llohe kolateralesh të cilat po i detajojmë më poshtë:

Mbrojtje e financiar e Kredise	Kolateral Financiar	Cash
		Letra me vlere
	Prona te patundshme	Prona te Patundshme Komerçiale (CRE)

		Prona te Patundshme Rezidenciale (RRE)
	Llogari te arketueshme	Kalim I te drejtave te te gjitha llogarive te arketueshme
		Kalim I te drejtave te llogarive te arketueshme nga nje kontrate specifike
	Kolaterale te tjera fizike	Peng mbi kuotat e biznesit
		Peng mbi makineri
		Peng mbi Inventar
		Peng mbi llogari te arketueshme
		Peng mbi pasuri te luajtshme
		Peng ne makina
	Sigurim Jete	
Mbrojtje e Pafinancuar e Kredise	Garanci	Garanci Shteterore
		Garanci Bankare
		Garanci Korporatore

Banka ka disa procedura te brendshme te cilat rregullojne vleresimin dhe administrimin e kolateraleve. Keto politika kane bazen ne parimet e meposhtme:

1. Prona duhet te kete nje titull ligjor te vlefshem

Titulli ligjor I kolateralit duhet te jete I dokumentuar shume mire dhe banka sigurohet qe inskripti mbi pronen ne fjale te jete ligjerisht I imponueshem sipas kuadrit ligjor te republikes se shqiperise.

2. Vlere e qendrueshme

Kolaterali duhet te ofroje vlere te qendrueshme te pakten per afatin maksimal te kontrates se kredise. Ky kusht monitorohet dhe vleresohet rregullisht. Ne rast te renies se vlerave banka merr masa te menjehereshme per permiresimin e situates.

3. Vlere e kthyeshme ne cash:

Kolaterali duhet te kete nje vlere e cila mund te kthehet ne cash ne nje kohe te arsyeshme, kjo e provuar nga eksperienca ne republiken e Shqiperise. Nese likuidimi I prone eshte I dyshueshem atehere kolaterali vleresohet me vlere 0

4. Pak ose aspak korrelacion

Korrelacioni I gjendjes financiare te klientit me kolateralin e marre per kredine duhet te jete shume I paket. Sa me I larte te jete korrelacioni midis te dyjave aq me e ulet eshte vlere e kolateralit. Nje shembull I korrelacionit te madh eshte perdorimi I nje Letre me Vlere e leshuar nga Kompania X si kolateral per nje kredi qe I jepet kesaj kompanie.

Ilojet kryesore të ofruesve të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë janë si më poshtë:

- Qeverite qendore dhe bankat qendore:
- qeverite locale
- Bankat multilaterale te zhvillimit:
 - the International Bank for Reconstruction and Development
 - the International Finance Corporation
 - the Inter-American Development Bank
 - the Asian Development Bank
 - the African Development Bank
 - the Council of Europe Development Bank
 - the Nordic Investment Bank
 - the Caribbean Development Bank
 - the European Bank for Reconstruction and Development
 - the European Investment Bank
 - the European Investment Fund
 - the Multilateral Investment Guarantee Agency
 - the International Finance Facility for Immunization
 - the Islamic Development Bank
 - the Inter-American Investment Corporation
 - the Black Sea Trade and Development Bank
 - the Central American Bank for Economic Integration
 - the CAF-Development Bank for Latin America
- Organizatat Nderkombetare:
 - Komuniteti European
 - Fondi MONetar Nderkombetar
 - the Bank for International Settlement
 - the European Financial Stability Facility
 - the European Stability Mechanism

- Njesite e sektorit publik.
- Banka dhe institucione financiare te vleresuara me nje gjendje mire financiare
- Korporate dhe kompani te tjera te cilat jane analizuar nga Banka Raiffeisen dhe jane vleresuar ne gjendje te mire financiare

LLOJI I MBROJTJES SE FINACUAR	EKSPOZIMI NE RASTIN E PERDORIMIT TE MBROJTJES SE FINANCUAR
Kolateral financiar	2,806,196,735.42
Netimi ne bilanc	-
Marreveshjet tip te netimit/kompensimit	-
Mbrojtje te tjera te pranueshme	-
LLOJI I MBROJTJES SE PAFINANCUAR	EKSPOZIMI NE RASTIN E PERDORIMIT TE MBROJTJES SE PAFINANCUAR
Garanci	20,787,909,849.25
Kundergaranci	-
Derivativet e kredise	-

Tabelë 9: Rreziku i kredisë së kundërpartisë (çdo tremujor)

N/A

Tabelë 10: Titullzimi (çdo tremujor)

N/A

Tabela 11: Rreziqet e tregut: Informacion I pergjithshem

Informacion Cilesor:

Mjaftueshmëria e kapitalit për rrezikun e tregut është llogaritur në bazë të Kapitulli VII te rregullores se Bankës së Shqipërisë “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”, pasi kushtet e mëposhtme nuk plotesohen per fundit e muajit Dhjetor 2017:

- a) gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, raporti i vlerës mesatare kontabël të librit të tregtueshëm ndaj totalit të aktivitetit nuk është më i lartë se 5%. Në asnjë kohë ky raport nuk është më i lartë se 6%;
- b) gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, vlera mesatare kontabël e librit të tregtueshëm nuk është më e lartë se 15 milionë euro. Në asnjë kohë kjo vlerë nuk është më e lartë se 20 milionë euro.

Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut është llogaritur si shuma e rrezikut të Pozicionit (Rreziku I Përgjithshëm dhe Rreziku Specifik), rrezikut të Përqendrimit në librin e tregtueshëm, Rreziku i Shlyerjes dhe rrezikut të Kursit të Këmbimit. Llogaritjet janë bazuar në metoden standarte.

- Rreziku I Pozicionit për titujt e borxhit
 - Rreziku I Përgjithshëm për titujt e borxhit është përlogaritur duke u bazuar në Metodën e Maturitetit të titujve.
 - Rreziku Specifik për titujt e borxhit bazuar në Shkallën e Cilesisë së Kredisë. Rreziku Specifik për librin e tregtueshëm për fundin e muajit Dhjetor 2017 është 0, pasi libri i tregtueshëm përbëhet vetëm nga tituj borxhi të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë Shkallën e Cilesisë së Kredisë 1 (RW është 0%).
- Rreziku I Përqendrimit në Librin e Tregtueshëm
Rreziku Përqendrimi në librin e tregtueshëm për fund muajin Dhjetor 2017 është 0, pasi pozicionet e rrezikut në librin e tregtueshëm të bankës nuk e tejkalojnë kufirin maksimal të lejuar për ekspozimet e mëdha, të përcaktuara në “Rregulloren për Menaxhimin e Ekspozimeve të mëdha të bankave” (libri I tregtueshëm I bankës përbehet tërësisht nga tituj të borxhit të Qeverisë Shqiptare.)
- Rreziku i Shlyerjes për shlyerjet e tipit Dorëzim Kundrejt Pageses (Delivery vs Payment) ose anasjelltas. Rreziku i shlyerjes për transaksionet DVP është 0 për portofolin e fund muajit Dhjetor 2017.
- Rreziku i kursit të këmbimit, përlogaritet në rastin kur pozicioni total neto i hapur valutës është më e lartë se 2% të kapitalit rregullator. Për fundin e muajit Dhjetor 2017, pozicioni total neto i hapur valutës është me e lartë se 2% të kapitalit rregullator, rrjedhimisht është përlogaritur kërkesa për kapital për këtë rrezik.

Informacion Sasior (mijë LEK):

	Ekspozimeve të ponderuara me rrezik	Kerkesa per Kapital
Shuma për rreziqet e tregut	1,919,071.97	153,525.76
Shuma e rrezikut te shlyerjes	-	-
Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	-	-
Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-	-
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)	1,919,071.97	153,525.76
Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	1,267,787.62	101,423.01
Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	-	-
Rreziku i kursit të këmbimit	651,284.35	52,102.75
Rreziku i investimeve në mallra	-	-

Tabela 12: Rreziku Operacional

Informacion Cilesor
<p>a)</p> <p>Banka Raiffeisen Perdor Metoden standarte per perllogaritjen e kerkesave per capital dhe Aktiveve te ponderuara me Risk per Rrezikun Operacional. Sipas kesaj metode, Te ardhurat Bruto (mesatarja e tre viteve te fundit) te Bankes Raiffeisen dhe Raiffeisen Leasing Sha.te siguruara nga sistemi SRU , ndahen ne tete linja binesi me risk operacional (sipas percaktimeve te rregullores se Bankes Se Shqiperise, Neni 185 tabela 30). Pastaj secila ndarje e te ardhurave bruto shumezohet me faktorin beta qe I korrespondon linjes se biznesit (β jane faktore te percaktuar). Me pas rezultati total - $\sum GIn \& \beta n$ – percakton kerkesen per capital per rrezikun operacional.</p> <p>Aktivet e ponderuara me risk perllogariten duke shumezuar kerkesen per capital me nje koeficient prej 12.5</p> <p>Perllogaritja e rrezikut operacional behet me baza vjetore ndersa raportimi behet me baza tremujore. Pra ketu paraqitet rreziku operacional llogaritur mbi bazen e te dhenave te bilancit te audituar te muajit Dhjetor 2017.</p> <p>(b)</p> <p>Kërkesa për kapital (EC) = ALL 1,765,707,785.41</p>

Tabela 15: Rreziku I Likuiditetit.

#N/A